VENDIM
Nr.51, datë 26.1.2011

PËR NJË SHTESË FONDI KOMITETIT NDËRMINISTROR TË EMERGJENCAVE CIVILE, PËR PËRBALLIMIN E SITUATËS EMERGJENTE TË KRIJUAR NË QARKUN E SHKODRËS, SI PASOJË E PËRMBYTJEVE NATYRORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", si dhe të nenit 31 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 "Për emergjencat civile", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Brendshme, në fondin financiar, programi "Emergjenca civile", t'i shtohet fondi prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh, i ndarë, si më poshtë vijon:

a) 270 000 000 (dyqind e shtatëdhjetë milionë) lekë, për blerjen e bazës ushqimore (koncentrat dhe bar i thatë), për periudhën janar-mars 2011.

b) 25 029 876 (njëzet e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekë, për kryerjen e punimeve emergjente në disa objekte (argjinatura) për mbrojtjen nga përmbytjet.

2. Fondi prej 295 029 876 (dyqind e nëntëdhjetë e pesë milionë e njëzet e nëntë mijë e tetëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lekësh të përballohet nga KESH sh.a. (Korporata Elektroenergjetike Shqiptare).

3. Ngarkohen Ministri i Financave, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Ministri i Brendshëm dhe KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha